



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 308, Datë 30.10.2023

MBI

MIRATIMIN E RREGULLORES SË ALOKIMIT NË HIJE TË KAPACITETEVE
(SHADOW AUCTION) NË KUADËR TË BASHKIMIT TË TREGJEVE SHQIPËRI-
KOSOVË

Në zbatim të neneve 16 dhe 65, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2170/1 prot., datë 26.10.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi shqyrtimin e propozimit të OST sh.a. për miratimin e Rregullores së alokimit në hije të kapaciteteve (Shadow Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë”,

Konstatohet se:

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., iu drejtua Entit Rregullator të Energjisë nëpërmjet shkresës nr. 3862 prot., datë 17.07.2023 me lëndë: “Propozim mbi miratimin e rregullave të procedurës së Alokimit në Hijë (Shadow Auction) të kapaciteteve në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë”.
- OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 4741 prot., datë 14.09.2023 ndër të tjera parashtron se: Ndryshmet në draftin e rregullores për (Shadow Auction) të Kapaciteteve në hije, konsistojnë si më poshtë vijon:
 - Afati për publikimin e rezultateve të ankandit - spostohet nga 13:30 në 14:20, D-1 (Neni 34);
 - Afati për njoftimin për aplikim të ankandit rezervë- spostohet nga 13:30 në 14:10, D1 (Neni 42);
 - Afati për njoftimin të rezultateve të ankandit rezervë- spostohet nga 13:40 në 14:20, D-1 (Neni 42);

- SECAO në komunikimin e përcjellë nga OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 4741 prot., datë 14.09.2023 ndër të tjera përcakton se këto modifikime të orarit nuk kanë efekte negative për pjesëtarët e tregut dhe që nuk është i detyrueshëm konsultimi i tyre. Në të njëjtën kohë SECAO do të njoftoi pjesëtarët e tregut.
- Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij akti, drafti i përcjellë nga OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3862 prot., datë 17.07.2023 dhe me qëllim realizimin e konsultimit publik të tij është realizuar publikimi i tij në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në rubrikën konsultime. Në vijim, duke qënë se me shkresën nr. 4741 prot., datë 14.09.2023, OST sh.a., ka përcjellë draftin e rregullores ku janë përfshirë ndryshimet e sipërcituara të orareve në nenet respektivisht 34 dhe 42 të saj, me qëllim realizimin e konsultimit publik të aktit me këto ndryshime është realizuar publikimi i tij në faqen e internetit të ERE-s në rubrikën konsultime në datën 19.09.2023, në të dy gjuhët, Shqip dhe Anglisht dhe deri në përfundim të afatit të kësaj vendimmarrje nuk ka patur asnjë koment nga palët e interesit.
- Vlerësojmë se në kuadër të bashkimit të tregjeve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, ERE ka ndjekur një proces hap pas hapi me qëllim plotësimin e kuadrit rregullator ku ndër aktet kryesore të miratuara nga ERE përfshihen:
 - Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike (Rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes). Këto rregulla janë miratuar njëkohësisht dhe nga Rregullatori i Kosovës (ZRE) pasi shërbejnë për operimin e ALPEX në të dy vendet.
 - Pas miratimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike me vendimin nr. 347/2022, më 12 Prill 2023 filloi për herë të parë operimin e tregut të ditës në avancë në Shqipëri, Bursa Shqiptare e Energjisë ALPEX sh.a., e cila në vijim pritet të fillojë dhe operimin e tregut të Energjisë elektrike brenda të njëjtës ditë në Kosovë.
 - Bordi i ERE-s me vendimin nr. 228 datë 17.07.2023, vendosi përcaktimin e ALPEX sh.a. si operator i emëruar i tregut të energjisë elektrike në tregun e bashkuar të Shqipërisë dhe Kosovës, nëpërmjet një vendimmarrjeje të përbashkët të dy rregullatorëve të Shqipërisë (ERE) dhe Kosovës (ZRE).
- Në këtë kontekst ndër aktet e nevojshme të cilat duhet të miratohen në kuadër të procesit të bashkimit të tregut të energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës janë dhe Rregullat e procedurës së Alokimit në Hije të kapaciteteve (Shadow Auction).
- Rregullat e propozuara nga OST sh.a., do të aplikohen në rastin kur bashkimi i tregut të ditës në avancë nuk mund të prodhojë rezultate, atëherë kalohet në aplikimin e këtyre rregullave si një procedure rezervë. Procedura rezervë për alokimin e Kapacitetit Ndërzonal në kornizën kohore të tregut të ditës në avancë është një Alokim Eksplicit i kapacitetit të interkoneksionit në formën e të Drejtave të Transmetimit Fizik të energjisë elektrike me bazë ditore.

- Rregullorja e Alokimit në Hije (Shadow Auction) përmban termat dhe kushtet për alokimin e të Drejtave të Transmetimit ditor në kufijtë e renditur në Shtojcën 1, respektivisht në kufirin Shqipëri – Kosovë (AL – KS), si procedurë rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë me kusht që Pjesëmarrësi i Regjistruar t'i pranojë këto rregulla me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.
- Rregullorja e Alokimit Shadow përcakton të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësve të Regjistruar si dhe kërkesat për pjesëmarrje në Ankandet Shadow, përshkruan procesin e Ankandit Shadow, duke përfshirë përcaktimin e Çmimit Marxhinal që del si rezultat i Ankandit Shadow, në të njëjtën kohë përfshin dhe mënyrën e faturimit dhe pagesës.
- Rregullorja e procedurës së Alokimit në Hije (Shadow Auction) të kapaciteteve në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë trajton gjithashtu çështjet lidhur me kërkesat dhe procesin për pjesëmarrje në ankandet shadow, kolaterale, ankande shadow, përdorimi i të drejtave të transmetimit, procedurat e kthimit, reduktimi, faturimi dhe pagesa si dhe ka të përfshirë Shtojcën 1 ku përcaktohen kufijtë e zonës së ofertimit për të cilën zbatohet kjo rregullore (AL- KS).
- Me VKM-në nr. 872, datë 27.12.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, të këshillit të ministrave, Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”*, në pikën 2 gërma (b) është përcaktuar ndër të tjera se: *OST-ja të vendosë në dispozicion të tregut të organizuar një sasi minimum (50%) të kapaciteteve ndërkuftare të disponueshme, që i përket bashkimit respektiv të tregjeve.*
- Duke marrë në konsideratë faktin se VKM nr. 872, datë 27.12.2022, e sipërcituar përcakton se (50%) të kapaciteteve ndërkuftare të disponueshme, respektivisht në kufirin AL-KS do të vendoset në dispozicion të tregut të përbashkët kur bashkimi i tregut të ditës në avancë nuk mund të prodhojë rezultate. Mund të ndodh që këto kapacitete të mos rialokohen dhe të sjellin konxhestione në këtë kufi. Miratimi i kësaj rregulloreje si procedurë rezervë për alokimin e Kapacitetit Ndërzonal në kornizën kohore të tregut të ditës në avancë është element i nevojshëm për rialokimin e këtij kapaciteti.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores së Alokimit në Hije të kapaciteteve (Shadow Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri - Kosovë. (bashkëlidhur)
2. Për çdo mospërputhje mes versionit Shqip dhe atij në gjuhën origjinale Angleze, palët duhet t'i referohen versionit në gjuhën Angleze.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

SEE CAO

Rregullorja e Alokimit në Hije

Versioni 1,0



Podgoricë, Mali i Zi
Shtator 2023

Përmbajtja

| | | |
|----------------|---|----|
| KREU 1 | Dispozita të përgjithshme..... | 5 |
| <i>Neni 1</i> | Objekti dhe fusha e veprimit..... | 5 |
| <i>Neni 2</i> | Përkufizimet dhe interpretimi..... | 5 |
| <i>Neni 3</i> | Platforma e Alokimit..... | 9 |
| <i>Neni 4</i> | Data e hyrjes në fuqi dhe aplikimi..... | 9 |
| KREU 2 | Kërkesat dhe procesi për pjesëmarrje në Ankandet Hije..... | 11 |
| <i>Neni 5</i> | Dispozitë e Përgjithshme..... | 11 |
| <i>Neni 6</i> | Lidhja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes..... | 11 |
| <i>Neni 7</i> | Forma dhe përmbajtja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes..... | 12 |
| <i>Neni 8</i> | Dorëzimi i informacionit..... | 12 |
| <i>Neni 9</i> | Garancitë..... | 13 |
| <i>Neni 10</i> | Llogari Biznesi e Dedikuar..... | 14 |
| <i>Neni 11</i> | Pranimi i Rregullave të Sistemit të Informacionit..... | 14 |
| <i>Neni 12</i> | Kostot lidhur me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes..... | 14 |
| <i>Neni 13</i> | Refuzimi i aplikimit..... | 14 |
| <i>Neni 14</i> | Aksesi në Mjedisin e Ankandit..... | 15 |
| <i>Neni 15</i> | Kryerja e kushteve financiare shtesë..... | 15 |
| <i>Neni 16</i> | Kërkesat rregullatore dhe ligjore..... | 15 |
| KREU 3 | Kolateralet..... | 16 |
| <i>Neni 17</i> | Dispozitat e përgjithshme..... | 16 |
| <i>Neni 18</i> | Forma e depozitës në para..... | 16 |
| <i>Neni 19</i> | Forma e Garancise Bankare..... | 17 |
| <i>Neni 20</i> | Vlefshmëria dhe rinovimi i Garancisë Bankare..... | 18 |
| <i>Neni 21</i> | Limiti i kreditit..... | 18 |
| <i>Neni 22</i> | Modifikimet e kolateraleve..... | 19 |
| <i>Neni 23</i> | Incidenti i kolateralit..... | 19 |
| <i>Neni 24</i> | Thirrjet për kolateral..... | 20 |
| KREU 4 | Ankande Hije..... | 21 |
| <i>Neni 25</i> | Dispozitat e përgjithshme për Ankandet Hije..... | 21 |
| <i>Neni 26</i> | Procesi i Ankandit Hije..... | 21 |
| <i>Neni 27</i> | Specifikimi i ankandit..... | 21 |
| <i>Neni 28</i> | Dorëzimi i ofertave..... | 22 |
| <i>Neni 29</i> | Regjistrimi i ofertës..... | 23 |
| <i>Neni 30</i> | Oferta e paracaktuar..... | 23 |
| <i>Neni 31</i> | Oferta e paracaktuar për Ankand rezervë..... | 24 |
| <i>Neni 32</i> | Verifikimi i Limitit të Kreditit..... | 24 |
| <i>Neni 33</i> | Përcaktimi i Rezultateve të Ankandit Hije..... | 25 |
| <i>Neni 34</i> | Njoftimi i Rezultateve të Ankandit Hije..... | 26 |
| KREU 5 | Përdorimi i të Drejtave të Transmetimit..... | 29 |
| <i>Neni 35</i> | Parime të përgjithshme..... | 29 |
| <i>Neni 36</i> | Nominimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik..... | 29 |
| <i>Neni 37</i> | Dokumenti i të Drejtave..... | 29 |
| <i>Neni 38</i> | Rezervimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik për shërbimet balancuese..... | 30 |

Rregullorja e Alokimit në Hije

| | | |
|-----------------|---|----|
| KREU 6 | Procedurat rezervë | 31 |
| <i>Neni 39</i> | Dispozita të përgjithshme..... | 31 |
| <i>Neni 40</i> | Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave | 32 |
| <i>Neni 41</i> | Procedura rezervë për Ankandin Hije | 32 |
| <i>Neni 42</i> | Ankandi rezervë | |
| <i>Neni 43</i> | Anulimi i Ankandit Hije | 33 |
| KREU 7 | Reduktimi | |
| <i>Neni 44</i> | Ngjarjet nxitëse dhe pasojat e reduktimit të të Drejtave të Transmetimit Ditor..... | 35 |
| <i>Neni 45</i> | Procesi dhe njoftimi i reduktimit..... | 35 |
| KREU 8 | Faturimi dhe Pagesa | 36 |
| <i>Neni 46</i> | Parime të përgjithshme | 36 |
| <i>Neni 47</i> | Llogaritja e shumave të pagueshme..... | 36 |
| <i>Neni 48</i> | Shtesa për Taksat..... | 36 |
| <i>Neni 49</i> | Kushtet e faturimit dhe pagesës | 37 |
| <i>Neni 50</i> | Mosmarrëveshjet për pagesën..... | 38 |
| <i>Neni 51</i> | Kamatëvonesës dhe incidenti i pagesës..... | 39 |
| KREU 9 | Dispozita të ndryshme..... | 40 |
| <i>Neni 52</i> | Kohëzgjatja dhe ndryshimi i Rregulles së Alokimit Hije..... | 40 |
| <i>Neni 53</i> | Përgjegjësia..... | 41 |
| <i>Neni 54</i> | Zgjidhja e mosmarrëveshjeve..... | 42 |
| <i>Neni 55</i> | Pezullimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes | 43 |
| <i>Neni 56</i> | Përfundimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes | 44 |
| <i>Neni 57</i> | Forca Madhore | 46 |
| <i>Neni 58</i> | Njoftimet | 46 |
| <i>Neni 59</i> | Konfidencialiteti | 47 |
| <i>Neni 60</i> | Delegimi dhe nënkontraktimi..... | 48 |
| <i>Neni 61</i> | Ligji rregullues..... | 49 |
| <i>Neni 62</i> | Gjuha | 49 |
| <i>Neni 63</i> | Pronësia intelektuale..... | 49 |
| <i>Neni 64</i> | Marrëdhëniet e Palëve | 49 |
| <i>Neni 65</i> | Nuk ka të drejta të palëve të treta | |
| <i>Neni 66</i> | Heqja dorë | 50 |
| <i>Neni 67</i> | Marrëveshja e plotë | 50 |
| <i>Neni 68</i> | Mjetet juridike ekskluzive..... | 50 |
| <i>Neni 69</i> | Ndashmëria | 51 |
| Shtojca 1 | | 52 |

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

1. Në rastin kur bashkimi i tregut të ditës në avancë nuk mund të prodhojë rezultate, atëherë kalohet te procedura rezervë. Procedura rezervë për alokimin e Kapacitetit Ndërzonal në kornizën kohore të tregut të ditës në avancë është një Alokim Eksplicit në formën e të Drejtave të Transmetimit Fizik (PTR) të energjisë elektrike me bazë ditore.
2. Rregullorja e Alokimit Hije përmban termat dhe kushtet për alokimin e të Drejtave të Transmetimit Ditor në kufijtë e renditur në Shtojcën 1, si procedurë rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë me kushtin që Pjesëmarrësi i Regjistruar ta pranojë këtë rregullore me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes. Në veçanti, Rregullorja e Alokimit Hije përcakton të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësve të Regjistruar si dhe kërkesat për pjesëmarrje në Ankandet Hije, përkrah procesin e Ankandit Hije, duke përfshirë përcaktimin e Çmimit Marxhinal si rezultat i Ankandit Hije dhe faturimit/pagesës.
3. Procedura rezervë i referohet vetëm Kapacitetit Ndërzonal dhe Pjesëmarrësit e Regjistruar nuk mund të përdorin asnjë të drejtë tjetër lidhur me të Drejtat e Transmetimit Fizik që u janë alokuar, përveç të drejtave që janë në përputhje me dispozitat e Rregullores së Alokimit Hije.
4. Dihet se funksionimi i Platformës së Alokimit mbulon zonën ku operojnë OST-të e Bashkimit Evropian, operatorët e sistemit të transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe operatorët e sistemit të transmetimit nga vende të tjera. Referencat për (a) OST ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit përfshijnë referencat ndaj OST-ve të BE-së, operatorëve të sistemit të transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe operatorëve të sistemit të transmetimit nga këto vende të tjera, dhe (b) Autoritetet Rregullore Kombëtare ose ARRK-të përfshijnë referenca ndaj ARRK-ve të BE-së dhe autoriteteve rregullore kombëtare përkatëse tek palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe shteteve të tjera përkatëse.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

1. Termat me shkronja të mëdha të përdorura në këtë Rregullore të Alokimit Hije do të kenë kuptimin që u jepet në nenin 2 të Rregullores (BE) 2019/943, nenin 2 të Rregullores (KE) 2013/543, nenin 2 të Rregullores (BE) 2015/1222, Neni 2 të Direktivës (BE) 2019/944, dhe në Rregulloren (BE) 2016/1719.
2. Përveç kësaj, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Filial nënkupton, në lidhje me çdo person, apo çdo subjekt tjetër që drejtpërdrejt ose tërthorazi kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët direkt ose indirekt me atë person sikurse përcaktohet kuptimi i kontrollit në Rregulloren e BE-së (KE) nr. 139/2004 të datës 20 janar 2004 për kontrollin e përqendrimeve midis ndërmarrjeve ose në legjislacionin e ngjashëm kombëtar;

Rregullorja e Alokimit në Hije

Platforma e Alokimit nënkupton një ent të emëruar dhe autorizuar nga Operatori(operatorët) e Sistemit të Transmetimit përgjegjës për të vepruar në emër të tyre dhe në emër të vet duke qenë një platformë e vetme alokimi ose platformë(a) rajonale për shpërndarjen e Kapacitetit Ditor Ndërzonal përmes Ankandeve Hije sikurse përcaktohet në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes;

Specifikimi i Ankandit nënkupton një listë me karakteristikat specifike të një ankandi Hije të caktuar, përfshirë këtu natyrën e produkteve të ofruara dhe datat përkatëse;

Mjedisi i Ankandit nënkupton sistemin e teknologjisë së informacionit që përdoret nga Platforma e Alokimit për të kryer Ankande dhe për të lehtësuar procedurat e tjera të përshkruara në Rregulloren e Alokimit Hije;

Garancia Bankare nënkupton një letër krediti gatishmërie të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme ose letër garancie të lëshuar nga një bankë;

Ofertë nënkupton çiftin e Sasisë së Ofertës dhe Çmimin e Ofertës së ofruar nga një pjesëmarrës i regjistruar që merr pjesë në Ankand;

Çmimi i Ofertës nënkupton çmimin që një pjesëmarrës i regjistruar është i gatshëm të paguajë për një (1) MW dhe orë të të Drejtave Ditore të Transmetimit;

Sasia e Ofertës nënkupton sasinë e të Drejtave Ditore të Transmetimit në MW të kërkuar nga një pjesëmarrës i regjistruar;

Periudha e Ofertimit nënkupton periudhën kohore brenda së cilës Pjesëmarrësit e Regjistruar që dëshirojnë të marrin pjesë në një ankand mund të dorëzojnë ofertat e tyre;

Llogaria e Biznesit nënkupton një llogari të dedikuar depozite të hapur nga Platforma e Alokimit me qëllim të sigurimit të kolateraleve në formën e depozitës në para nga pjesëmarrësit e regjistruar, e cila mund të përdoret për pagesa nga pjesëmarrësi i regjistruar;

Identifikimi i Marrëveshjes së Kapacitetit (CAI) nënkupton kodin unik të identifikimit të caktuar për çdo të drejtë të transmetimit fizik nga mjeti i ankandit gjatë ankandit Hije. Kodi i identifikimit përdoret edhe kur përdorimi i të Drejtës Fizike të Transmetimit u propozohet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit;

Limiti i Kreditit nënkupton shumën e kolateraleve që mund të përdoren për të mbuluar çdo dorëzim të Ofertës në Ankandet e mëvonshme dhe nuk përdoret për detyrimet e papaguara të pagesës;

E Drejta Ditore e Transmetimit nënkupton, për qëllimet e Rregullores së Alokimit Hije, një të Drejtë Fizike Transmetimi të fituar në Ankandin Hije;

Bashkimi i Tregut të Ditës në Avancë nënkupton procesin e ankandit ku porosinë e mara përputhen dhe kapaciteti ndërzonal ndahet njëkohësisht për zona të ndryshme ofertimi në tregun e ditës në avancë;

Kodi EIC nënkupton Skemën e Kodimit të identifikimit të energjisë të ENTSO-E që identifikon palët në një tregti ndërkufitare;

Ankandi Rezervë nënkupton procesin me të cilin Platforma e Alokimit i atribuon kapacitetet një Pjesëmarrësi të Regjistruar në rast se është aktivizuar modaliteti rezervë;

Forcë madhore nënkupton çdo ngjarje ose situatë të paparashikueshme, të pazakontë e përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale dhe/ose Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmetimit, dhe jo për shkak të fajit të Palës dhe/ose Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmetimit, e cila nuk mund të shmanget ose kapërcehet me largpamësi dhe kujdes të arsyeshëm, e cila nuk mund të zgjidhet me masa të cilat nga pikëpamja teknike, financiare ose ekonomike janë në mënyrë të arsyeshme të mundshme për Palën dhe/ose operatorët përkatës të sistemit të transmetimit, e cila ka ndodhur realisht dhe është objektivisht e verifikueshme dhe që bën të pamundur që Pala dhe/ose Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit të përmbushin, përkohësisht ose përgjithmonë, detyrimet e tyre;

Rregullat e Sistemit të Informacionit nënkuptojnë termat dhe kushtet për aksesin dhe përdorimin e Mjedisit të Ankandit nga Pjesëmarrësit e Regjistruar siç janë publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;

Çmimi Marxhinal nënkupton çmimin e përcaktuar në një ankand të caktuar për t'u paguar nga të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar për çdo MW dhe orë të së Drejtës Ditore të fituar të Transmetimit;

Autoritetet Rregullatore Kombëtare nënkupton autoritetet rregullatore të referuara në nenin 35(1) të Direktivës 2009/72/KE ose, siç mund të jetë rasti, legjislacioni i ngjashëm kombëtar;

Nominimi nënkupton njoftimin e përdorimit të Kapacitetit Ndërzonal nga një mbajtës i të Drejtave Fizike të Transmetimit dhe, nga kundërpala e tij, ose një palë e tretë e autorizuar, për Operatorin(ët) përkatës të Sistemit të Transmetimit;

Rregullat e Nominimit nënkupton rregullat për njoftimin e përdorimit të të drejtave të transmetimit tek Operatori(ët) përkatës të Sistemit të Transmetimit;

Marrëveshja e Pjesëmarrjes nënkupton marrëveshjen, me anë të së cilës Palët marrin përsipër të respektojnë termat dhe kushtet për alokimin e kapaciteteve në përputhje me Rregulloren e Alokimit Hije;

Pala/Palët nënkupton Platformën e Alokimit dhe/ose një Pjesëmarrës të Regjistruar referuar më vete si Pala ose së bashku si Palë;

E Drejta e Transmetimit Fizik nënkupton një të drejtë që i jep mbajtësit të saj të drejtën për të transferuar fizikisht një vëllim të caktuar të energjisë elektrike në një periudhë të caktuar kohore ndërmjet dy Zonave Ofertuese në një drejtim të caktuar;

Periudha e Produktit nënkupton kohën dhe datën në të cilën fillon e drejta për të përdorur të Drejtën Ditore të Transmetimit dhe kohën dhe datën në të cilën përfundon e drejta për të përdorur të Drejtën Ditore të Transmetimit;

Pjesëmarrës i Regjistruar nënkupton një pjesëmarrës tregu i cili ka lidhur një Marrëveshje Pjesëmarrjeje me Platformën e Alokimit;

Dokumenti i të Drejtave nënkupton dokumentin që përmban informacionin për sasinë

Rregullorja e Alokimit në Hije

maksimale të të Drejtave të Transmetimit Fizik (të identifikuar nga CAI) që mund të emërohet nga një pjesëmarrës tregu për kufirin e zonës së ofertimit në ditë/orë/drejtimit duke marrë parasysh vëllimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit të fituara fillimisht dhe reduktimet e mundshme që kanë ndodhur para lëshimit të Dokumentit të të Drejtave;

Rregullorja e Alokimit Hije nënkupton rregulloren për procedurën rezervë për alokimin e Kapacitetit Ndërzonal në kornizën kohore të tregut të ditës pasuese të aplikuara nga Platforma e Alokimit;

Ankandi Hije nënkupton ankandin explicit të organizuar nga platforma(at) e alokimit me anë të të cilit Kapaciteti Ditor Ndërzonal ofrohet si procedurë rezervë për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe u ndahet pjesëmarrësve të tregut që paraqesin oferta(t);

Përdore ose Humbe (UIOLI) nënkupton një aplikim automatik me të cilin Kapaciteti Ditor Ndërzonal i të Drejtave të Transmetimit Fizik të pa-nominuar i kthehet në mënyrë të pakthyeshme OST(ve) përkatëse dhe mbajtësit e të Drejtave të Transmetimit që nuk nominojnë të përdorin të drejtat nuk kanë të drejtë të marrin pagesë;

Ditë Pune nënkupton ditët kalendarike nga e hëna në të premte, me përjashtim të festave publike siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;

Orari i Punës nënkupton orët e përcaktuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

3. Në këtë Rregullore të Alokimit Hije, përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe:
 - (a) çdo referencë për fjalën kufi të Zonës së Ofertimit mund të mbulojë të gjithë interkoneksionet së bashku ose më vete, ose një nëngrup interkoneksionesh në këtë kufi të Zonës së Ofertimit, sikurse specifikohet në Shtojcën 1 të Rregullores së Alokimit Hije;
 - (b) njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;
 - (c) referencat për një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë e tjera;
 - (d) tabela e lëndës, titujt dhe shembujt janë futur vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e Rregullores së Alokimit Hije;
 - (e) fjala “përfshirë” dhe variacionet e saj duhet të interpretohen pa kufizim;
 - (f) çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë akti tjetër do të përfshijë çdo modifikim, zgjerim ose ri-miratim të tij kur është në fuqi;
 - (g) çdo referencë për marrëveshje apo dokument tjetër, ose ndonjë akt ose instrument tjetër duhet të interpretohet si referencë ndaj asaj marrëveshjeje ose dokumenti, akti apo instrumenti tjetër të amenduar, ndryshuar, plotësuar, zëvendësuar ose rinovuar herë pas here;
 - (h) referenca për orën është referencë për orën zonale CET/CEST, përveç nëse specifikohet ndryshe; dhe
 - (i) kur Platformës së Alokimit i kërkohet të publikojë informacion sipas kësaj Rregullorjeje të Alokimit Hije, duhet ta bëjë duke i vënë informacionin ose të dhënat

Rregullorja e Alokimit në Hije

e disponueshme në faqen e saj të internetit dhe/ose nëpërmjet Mjedisit të Ankandit.

Neni 3 Platforma e Alokimit

1. Platforma e Alokimit do të ndërmarrë funksionet e alokimit në përputhje me Rregulloren e Alokimit Hije, legjislacionin në fuqi të Bashkimit Evropian ose aktet ligjore në fuqi të Komunitetit të Energjisë dhe/ose legjislacionin kombëtar në fuqi të një ose më shumë vendesh kufitare të Zonës Ofertuese.
2. Platforma e Alokimit zhvillon Ankandin Hije për mosdisponueshmërinë e paparashikuar dhe të parashikuar të bashkimit të tregut të ditës në avancë në kufijtë përkatës të Zonës së Ofertimit. Ajo kryen procesin e regjistrimit, trajton menaxhimin e nevojshëm të riskut financiar, përgatit dhe kryen Alokimet Hije, siguron të gjithë informacionin e nevojshëm për Pjesëmarrësit e Regjistruar dhe OST-të dhe mbledh pagesat dhe/ose paguan sipas Rregullores së Alokimit Hije.
3. Për qartësim, Platforma e Alokimit hyn në një marrëdhënie kontraktuale me Pjesëmarrësit e Regjistruar. Caktimi i një Platforme të re Alokimi nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja e Alokimit Hije.
4. Për qëllimet e Rregullores së Alokimit Hije, Platforma e Alokimit është pala që nënshkruan Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësin e Regjistruar.
5. Për qëllimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësin e Regjistruar, Platforma e Alokimit publikon një version të konsoliduar të Rregullores së Alokimit Hije pasi të hyjë në fuqi në përputhje me regjimet rregullatore kombëtare në fuqi. Në rast të një konflikti midis versionit të konsoliduar nga Platforma e Alokimit dhe Rregullores së Alokimit Hije të hyrë në fuqi në përputhje me regjimet rregullatore kombëtare të zbatueshme, mbizotëron kjo e fundit.

Neni 4 Data e hyrjes në fuqi dhe aplikimi

1. Rregullorja e Alokimit Hije hyn në fuqi në përputhje me regjimin rregullator kombëtar të zbatueshëm dhe në datën e shpallur nga Platforma e Alokimit.
2. Rregullorja e Alokimit Hije i nënshtrohet legjislacionit që mbizotëron në kohën kur ato hyjnë në fuqi. Në rast se ka një ndryshim në legjislacion ose veprim nga autoritetet kompetente në nivel kombëtar ose të Bashkimit Evropian që ndikon mbi Rregulloren e Alokimit Hije, atëherë, pavarësisht nga dispozitat e tjera të Rregullores së Alokimit Hije, Rregullorja e Alokimit Hije do të ndryshohen përkatësisht dhe sipas nenit 52.
3. Në rast të një mospërputhjeje ndërmjet Rregullores së Alokimit Hije dhe Rregullores së Nominimit, për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ankandeve Hije në përputhje me Rregulloren e Alokimit Hije, mbizotëron Rregullorja e Alokimit Hije.
4. Aktivitetet e Platformës së Alokimit mbulojnë juridiksionet ku OST-të nga Bashkimi Evropian, OST nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe nga një ose më shumë vende të tjera. Referencat për (a) OST ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit përfshijnë si rrjedhim referenca për OST-të e BE-së, operatorët e sistemit të transmetimit nga palët

Rregullorja e Alokimit në Hije

kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe operatorët e sistemit të transmetimit nga çdo vend tjetër për të cilin shërbimet ofrohen nga Platforma e Alokimit, dhe (b) ARRK ose Autoriteti Rregullator Kombëtar përfshin referenca ndaj ARRK-ve të Bashkimit Evropian, ose ARRK-ve nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, apo rregullatorëve të vendeve të tjera që kanë juridiksion mbi OST-në përkatëse ose Platformën e Alokimit.

Kërkesat dhe procesi për pjesëmarrje në Ankandet Hije

Neni 5

Dispozitë e Përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e tregut mund të fitojnë një të Drejtë Transmetimi në kuadrin e tregut të ditës në avancë nëpërmjet Ankandeve Hije vetëm nëse Ankandet Hije nisen nga procedura rezervë.
2. Pjesëmarrja në Ankandet Hije kërkon që pjesëmarrësi i tregut:
 - (a) të lidhë një Marrëveshje Pjesëmarrjeje të vlefshme dhe efektive në përputhje me nenet 6 deri në 13; dhe
 - (b) të ketë akses në Mjedisin e Ankandit në përputhje me Nenin 14.
3. Pjesëmarrja në Ankandet Hije kërkon që pjesëmarrësit e tregut, përveç kushteve të parashikuara në paragrafin e mëparshëm, të plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:
 - (a) të jenë në përputhje me kërkesat për sigurimin e kolateraleve siç specifikohet në KREUN 3; dhe
 - (b) të pranojnë kushte financiare shtesë kur nevojiten në përputhje me Nenin 15.
4. Në çdo rast, pjesëmarrësit e tregut duhet të përmbushin detyrimet e përcaktuara në krerët përkatës të Rregullores së Alokimit Hije.

Neni 6

Lidhja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Për të qenë palë në një Marrëveshje Pjesëmarrjeje, pjesëmarrësit e tregut mund të aplikojnë, të paktën nëntë (9) ditë pune para pjesëmarrjes së parë në një Ankand Hije, duke dorëzuar në Platformën e Alokimit dy (2) kopje të nënshkuara të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, në rastin e nënshkrimeve të shkruara me dorë sikurse publikohen në faqen e internetit të Platformës së Alokimit, së bashku me të gjithë informacionin dhe dokumentet e plotësuara të kërkuara nga Nenet 7 deri 14. Marrëveshja e Pjesëmarrjes nënshkruhet në mënyrë alternative me nënshkrim(a) të shkruar me dorë ose nënshkrim(t) elektronik të kualifikuar (QES). Platforma e Alokimit e vlerëson plotësinë e informacionit të dorëzuar në përputhje me Nenet 8 dhe 11 brenda shtatë (7) ditësh pune nga marrja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të nënshkuar.
2. Platforma e Alokimit para skadimit të afatit prej shtatë (7) ditësh pune i kërkon pjesëmarrësit të tregut të sigurojë informacionin e rëndësishëm që pjesëmarrësi i tregut nuk e ka dorëzuar së bashku me Marrëveshjen e tij të Pjesëmarrjes. Pas marrjes së informacionit të rëndësishëm, Platforma e Alokimit e shqyrton informacionin brenda shtatë (7) ditësh pune shtesë dhe e njofton pjesëmarrësin e tregut nëse kërkohet informacion i mëtejshëm.
3. Pasi Platforma e Alokimit të ketë marrë të gjithë informacionin e nevojshëm, ajo i kthen një kopje të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të nënshkuar prej saj pjesëmarrësit të tregut pa vonesa të panevojshme. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes nga Platforma e Alokimit nuk tregon në vetvete pajtueshmërinë me ndonjë kusht tjetër të vendosur në Rregulloren e

Rregullorja e Alokimit në Hije

Alokimit Hije për pjesëmarrjen në Ankandet Hije. Marrëveshja e Pjesëmarrjes hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Platforma e Alokimit.

4. Është përgjegjësi e çdo pjesëmarrësi të tregut të sigurojë që është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe, sipas rastit, me legjislacionin ose aktet ligjore të Bashkimit Evropian të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e autoriteteve kompetente përkatëse, dhe se i ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme për pjesëmarrje në Ankandet Hije.
5. Në rast se pjesëmarrësi i tregut është tashmë pjesëmarrës i regjistruar në Platformën e Alokimit, ai duhet vetëm të plotësojë kërkesat e munguara/shtesë të përshkruara në Rregulloren e Alokimit Hije duke respektuar specifikat e paragrafit të mëparshëm të këtij neni.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Forma e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes dhe kërkesat për plotësimin e saj publikohen nga Platforma e Alokimit dhe mund të ndryshohen herë pas here prej saj pa ndryshuar asnjë term dhe kusht të specifikuar në Rregulloren e Alokimit Hije, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Rregulloren e Alokimit Hije.
2. Marrëveshja e Pjesëmarrjes i kërkon minimalisht pjesëmarrësit të tregut që:
 - (a) të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm në përputhje me Nenin 8 dhe Nenin 11; dhe
 - (b) të pranojë detyrimin ligjor dhe të pajtohet me Rregulloren e Alokimit Hije.
3. Platformën e Alokimit dhe Pjesëmarrësin e Regjistruar nuk i pengon asgjë nga Rregullorja e Alokimit Hije për të rënë dakord në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes për rregulla shtesë, jashtë fushëveprimit të Rregullosës së Alokimit Hije.
4. Në rast vështirësie në interpretim, kontradikte apo paqartësie midis Rregullosës së Alokimit Hije dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, teksti i Rregullosës të Alokimit Hije do të mbizotërojë.

Neni 8

Dorëzimi i informacionit

1. Pjesëmarrësi i tregut paraqet informacionin e mëposhtëm së bashku me Marrëveshjen e plotësuar dhe nënshkruar të Pjesëmarrjes:
 - (a) emrin dhe adresën e regjistruar të pjesëmarrësit në treg, përfshirë emailin e përgjithshëm dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit në treg për njoftimet sipas Nenit 58.
 - (b) nëse pjesëmarrësi i tregut është person juridik, një ekstrakt të regjistrimit të pjesëmarrësit të tregut në regjistrin tregtar të autoritetit kompetent;
 - (c) të dhënat e kontaktit dhe emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar pjesëmarrësin në treg dhe funksionin përkatës;
 - (d) Numrin e regjistrimit të TVSH-së së BE-së ose informacionin e ngjashëm të identifikimit tatimor ku TVSH-ja e BE-së nuk zbatohet;

Rregullorja e Alokimit në Hije

- (e) Taksat dhe tatimet që duhet të merren parasysh për faturat dhe llogaritjet e kolateralit;
 - (f) Kodin e Identifikimit të Energjisë (EIC);
 - (g) informacionin e llogarisë bankare për pagesën ndaj aplikantit që do të përdoret nga Platforma e Alokimit për qëllimet e Nenit 49 paragrafi 7;
 - (h) personin e kontaktit financiar për kolateralet, çështjet e faturimit dhe pagesave, dhe të dhënat e kontaktit të tij (email dhe numrin e telefonit) për njoftimet kur kërkohet nga Rregullorja e Alokimit Hije sipas Nenit 58;
 - (i) personin e kontaktit tregtar dhe të dhënat e tij të kontaktit (email dhe numrin e telefonit) për njoftimet kur kërkohet nga Rregullorja e Alokimit Hije sipas Nenit 58;
 - (j) personin e kontaktit operacional dhe të dhënat e kontaktit të tij (email dhe numër telefoni) për njoftimet kur kërkohet nga Rregullorja e Alokimit Hije sipas Nenit 58; dhe
2. Një Pjesëmarrës i Regjistruar garanton që të gjitha të dhënat dhe informacionet e tjera që i jep Platformës së Alokimit në përputhje me Rregulloren e Alokimit Hije (duke përfshirë informacionin në Marrëveshjen e tij të Pjesëmarrjes) janë dhe mbeten të sakta dhe të plota në të gjitha aspektet materiale dhe njofton menjëherë Platformën e Alokimit për ndryshimet.
 3. Pjesëmarrësi i Regjistruar njofton Platformën e Alokimit nëse ka ndonjë ndryshim në informacionin e paraqitur në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, të paktën nëntë (9) ditë pune para se ndryshimi të hyjë në fuqi dhe, kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi Pjesëmarrësi i Regjistruar merr dijeni për ndryshimin.
 4. Platforma e Alokimit konfirmon regjistrimin e ndryshimit ose i dërgon njoftim refuzimi të regjistrimit për ndryshimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar, maksimumi shtatë (7) ditë pune pas marrjes së njoftimit përkatës të ndryshimit. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Nëse Platforma e Alokimit refuzon të regjistrojë ndryshimin, arsyeja jepet në njoftimin e refuzimit.
 5. Ndryshimi bëhet i vlefshëm në ditën e dorëzimit të konfirmimit tek Pjesëmarrësi i Regjistruar.
 6. Nëse kërkohet informacion shtesë nga një Pjesëmarrës i Regjistruar si pasojë e një amendimi të Rregullores së Alokimit Hije, atëherë Pjesëmarrësi i Regjistruar dorëzon informacionin shtesë në Platformën e Alokimit brenda dymbëdhjetë (12) ditësh pune pas kërkesës për një dorëzim të tillë nga Platforma e Alokimit.

Neni 9 Garancitë

1. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, pjesëmarrësi i tregut garanton që:
 - (a) nuk ka filluar asnjë procedurë për të kërkuar gjykim të paaftësisë paguese ose falimentimit apo ndonjë lehtësim tjetër në përputhje me ligjet për paaftësinë paguese ose falimentimin, apo ligje të tjera të ngjashme që prek të drejtat e kreditorëve;
 - (b) nuk ka filluar asnjë proces paaftësie paguese, falimentimi ose procese të tjera të ngjashme ligjore që prekin të drejtat e kreditorëve në lidhje me aplikantin;

Rregullorja e Alokimit në Hije

- (c) nuk ka filluar asnjë proces mbylljeje ose likuidimi në lidhje me aplikantin; dhe
- (d) nuk ka detyrime pagese të vonuara ndaj Platformës së Alokimit.

Neni 10 Llogari Biznesi e Dedikuar

Si pjesë e dorëzimit të informacionit në përputhje me Nenet 6 dhe 8, në dispozicion të pjesëmarrësit në treg vihet një Llogari Biznesi e Dedikuar për qëllime të depozitimit të kolateraleve në para dhe/ose për qëllime të kryerjes së pagesave në bazën e përshkruar në Nenin 49.

Neni 11 Pranimi i Rregullave të Sistemit

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, pjesëmarrësi i tregut pranon Rregulloren e Sistemit në fuqi për operim, të ndryshuar herë pas here dhe të publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.

Neni 12 Kostot lidhur me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes

Të gjitha aplikimet për t'u bërë Pjesëmarrës i Regjistruar dhe pjesëmarrjet e mëvonshme në Ankandet Hije do të jenë me koston, shpenzimet dhe riskun e vetë Pjesëmarrësit të Regjistruar. Platforma e Alokimit nuk mban përgjegjësi ndaj asnjë personi për asnjë kosto, dëmtim ose shpenzim në lidhje me Pjesëmarrësin e Regjistruar që merr pjesë në Ankandet Hije, përveç rasteve kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në Rregulloren e Alokimit Hije.

Neni 13 Refuzimi i aplikimit

Platforma e Alokimit mund të refuzojë lidhjen e një Marrëveshje Pjesëmarrjeje me pjesëmarrësin e tregut në rrethanat e mëposhtme:

- (a) kur aplikanti nuk ka dorëzuar një Marrëveshje Pjesëmarrjeje të plotësuar dhe të nënshkruar siç duhet në përputhje me Nenet 6, 7 dhe 8; ose
- (b) Platforma e Alokimit ka zgjidhur më parë një Marrëveshje Pjesëmarrjeje me aplikantin si rezultat i një shkeljeje të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes nga Pjesëmarrësi i Regjistruar në përputhje me Nenin 56 (3) dhe (4) dhe përveç nëse rrethanat që çojnë në zgjidhjen e marrëveshjes kanë pushuar së ekzistuari ose Platforma e Alokimit është e kënaqur në mënyrë të arsyeshme që shkelja nuk do të ndodhë më; ose
- (c) nëse lidhja e një Marrëveshjeje Pjesëmarrjeje me aplikantin do të përbënte shkak që Platforma e Alokimit të shkelte ndonjë kusht të kërkesave të detyrueshme ligjore ose rregullatore; ose
- (d) nëse ndonjë nga garancitë e Pjesëmarrësit të Regjistruar sipas nenit 9 rezulton të jetë e pavlefshme ose e rreme;
- (e) nëse aplikanti është nën sanksione ekonomike dhe tregtare të cilat mund të kenë ndikim në Platformën e Alokimit.

*Neni 14
Aksesi në Mjedisin e Ankandit*

1. Platforma e Alokimit jep akses në Mjedisin e Ankandit pa pagesë nëse përmbushen kërkesat në vijim:
 - (a) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka nënshkruar dhe dorëzuar formularin e plotësuar të përfshirë në Rregulloren e Sistemit të Informacionit që identifikon personin (at) për të cilin(ët) krijohet llogaria(të) e përdoruesit në Mjedisin e Ankandit; dhe
 - (b) Pjesëmarrësi i Regjistruar i ka përmbushur kërkesat për autentifikim sic kërkohen nga Rregullat e Sistemit të Informacionit të publikuar nga Platforma e Alokimit.
2. Platforma e Alokimit konfirmon krijimin e llogarisë së përdoruesit ose mund t'i dërgojë një njoftim refuzimi Pjesëmarrësit të Regjistruar, më së voni pesë (5) ditë pune pas marrjes së formularit përkatës të plotësuar dhe nënshkruar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.
3. Platforma e Alokimit dërgon njoftimin e refuzimit të arsyetuar nëse nuk përmbushen kërkesat e renditura në paragrafin 1 të këtij Neni dhe nuk jep akses në Mjedisin e Ankandit.

*Neni 15
Përmbledhja e kushteve financiare shtesë*

Platforma e Alokimit mund të zhvillojë dhe publikojë kushte financiare standarde shtesë që duhet të pranohen nga Pjesëmarrësit e Regjistruar. Këto kushte financiare shtesë mund të përfshijnë dispozita për të mundësuar kolaterale të përbashkët për procese të tjera të organizuara nga Platforma e Alokimit në përputhje me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, për sa kohë që këto kushte financiare shtesë përputhen me Rregulloren e Alokimit Hije.

*Neni 16
Kërkesat rregullatore dhe ligjore*

Është përgjegjësi e çdo pjesëmarrësi të tregut të sigurojë që është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe, sipas rastit, me legjislacionin ose aktet ligjore të Bashkimit Evropian të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e autoriteteve kompetente përkatëse, dhe se i ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme për pjesëmarrje në Ankandet Hije, ose në përdorimin e të Drejtave të Transmetimit Ditor.

Kolateralet

Neni 17

Dispozitat e përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar ofrojnë kolaterale për të siguruar pagesat për Platformën e Alokimit që rezultojnë nga Ankandet Hije të të Drejtave të Transmetimit Ditor dhe, kur është e aplikueshme, pagesat e tjera të mundshme që duhet të paguhen sipas kushteve financiare shtesë në përputhje me Nenin 15.
2. Do të pranohen vetëm format e mëposhtme të kolateralit:
 - (a) Garanci Bankare;
 - (b) depozitë në para në një Llogari Biznesi të dedikuar.
3. Kolateralet mund të sigurohen në një nga format e përmendura në pikën 2 të këtij Neni ose një kombinim i këtyre formave, me kusht që Platforma e Alokimit të ketë të drejtën përfituese të kolateralit të plotë.
4. Limiti i Kreditit duhet të jetë gjithmonë më i madh ose i barabartë me zero.
5. Kolateralet do të jepen në Euro (€).

Neni 18

Forma e depozitës në para

Për kolateralet që jepen në formën e një depozite në para në një Llogari të dedikuar Biznesi vlejnë kushtet e mëposhtme:

- (a) paratë depozitohen në një Llogari Biznesi të dedikuar në institucionin financiar të zgjedhur nga Platforma e Alokimit;
- (b) Llogaria e dedikuar e Biznesit hapet dhe përdoret sipas kushteve financiare shtesë në përputhje me Nenin 15;
- (c) deri në momentin e tërheqjes siç lejohet nga dispozitat e mëposhtme të Nenit 24, depozitimi i parave në Llogarinë e dedikuar të Biznesit i takon Pjesëmarrësit të Regjistruar nëse nuk përcaktohet ndryshe në kushtet financiare shtesë në përputhje me Nenin 15;
- (d) tërheqjet nga Llogaria e Dedikuar e Biznesit në përputhje me Nenin 22 dhe Nenin 24 mund të bëhen vetëm me udhëzim të Platformës së Alokimit;
- (e) Llogaria e dedikuar e Biznesit mund të përdoret edhe për shlyerje siç parashikohet në Nenin 49; dhe
- (f) interesi mbi shumën e depozituar në Llogarinë e Dedikuar të Biznesit rritet në përfitim të Pjesëmarrësit të Regjistruar, pas zbritjes së taksave dhe tarifave bankare, nëse ka.

Neni 19
Forma e Garancise Bankare

1. Kolateralet që jepen në formën e një garancie bankare duhet të jenë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:
 - (a) Garancia Bankare jepet në formën e modelit të disponueshëm në faqen e internetit të Platformës së Alokimit dhe të përditësuar herë pas here ose në një formë që në thelb ndjek modelin;
 - (b) Garancia Bankare shkruhet në gjuhën angleze;
 - (c) Garancia Bankare mbulon të gjitha ankandet e organizuara nga Platforma e Alokimit sipas kushteve financiare shtesë në përputhje me Nenin 15;
 - (d) Garancia Bankare lejon tërheqje të pjesshme dhe të shumëfishta nga Platforma e Alokimit deri në shumën maksimale të garantuar;
 - (e) Garancia Bankare siguron pagesën me kërkesën e parë të Platformës së Alokimit. Gjithashtu, duhet të parashikojë që, nëse Platforma e Alokimit kërkon Garancinë Bankare, banka të paguajë automatikisht pa asnjë kusht tjetër përveç marrjes së kërkesës të dërguar me SWIFT nëpërmjet bankës ndërmjetëse që konfirmon se nënshkrimet në kërkesë janë në përputhje me ekzemplarët e mbajtur nga banka.
 - (f) Garancia Bankare është e parevokueshme, e pakushtëzuar dhe e patransferueshme;
 - (g) Garancia Bankare mund të përfshijë si mënyrë alternative nënshkrime me shkrim dore ose nënshkrime elektronike të kualifikuara (QES) nga banka emetuese. Në rast se Garancia Bankare nënshkruhet me nënshkrim(e) elektronik të kualifikuar (QES), të gjitha ndryshimet e mëposhtme do të nënshkruhen me nënshkrim(e) elektronik të kualifikuar (QES);
 - (h) banka që lëshon Garancinë Bankare duhet të jetë e themeluar në mënyrë të përhershme, duke përfshirë një degë në një shtet anëtar të BE-së, Zonën Ekonomike Evropiane, Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Vendin Vëzhgues të Komunitetit të Energjisë ose Zvicër dhe do të jetë e pranueshme për bankën e biznesit të Platformës së Alokimit;
 - (i) banka që lëshon garancinë bankare ose grupi financiar të cilit i përket duhet të ketë një vlerësim afatgjatë të kreditit prej jo më pak se BBB- nga Standard and Poor's Corporation, BBB- nga Fitch ose Baa3 nga Moody's Investors Service Inc. Nëse banka emetuese ose grupi financiar të cilit i përket banka emetuese, pushon së pasuri vlerësimin e kërkuar afatgjatë të kreditit, Pjesëmarrësi i Regjistruar brenda pesë (5) ditë pune duhet të paraqesë në Platformën e Alokimit një Garanci Bankare zëvendësuese nga një bankë në përputhje me kriterin afatgjatë të kërkuar, vlerësimin e kreditit ose zëvendësimin e Garancisë Bankare me depozitë. Nëse ka ulje të klasifikimit të institucioneve financiare në të gjithë industrinë, Platforma e Alokimit mund të hetojë se cilat janë standardet e reja dhe, sipas gjykimit të saj, nëse e sheh të nevojshme, të ulë vlerësimin e kërkuar për një periudhë të kufizuar kohore, duke informuar Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe duke u kërkuar që të informojnë Autoritetet Rregullatore Kombëtare.

Rregullorja e Alokimit në Hije

- (j) (banka që lëshon Garancinë Bankare nuk duhet të jetë filial i Pjesëmarrësit të Regjistruar për të cilin është lëshuar Garancia Bankare.
2. Garancia bankare duhet të përmbajë sa vijon:
- (a) një shumë maksimale të garantuar;
 - (b) identifikimin e Platformës së Alokimit si përfitues, siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (c) llogarinë bankare të Platformës së Alokimit, siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (d) adresën e bankës së Platformës së Alokimit, siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (e) identifikimin e plotë të Pjesëmarrësit të Regjistruar, duke përfshirë emrin, adresën, regjistrin tregtar/të shoqërisë;
 - (f) identifikimin e plotë të bankës sigurorese; dhe
 - (g) afatin e vlefshmërisë.
3. Pjesëmarrësi i Regjistruar e dorëzon garancinë bankare së paku katër (4) ditë pune para mbylljes së periudhës së ofertimit të ankandit Hije, për të cilin do të përdoret si kolateral ose në të kundërt do të konsiderohet për Ankandet Hije pasuese.
4. Platforma e Alokimit e pranon Garancinë Bankare të dhënë nga Pjesëmarrësi i Regjistruar nëse ajo është dhënë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në paragrafin 1 deri 2 të këtij Neni dhe, në rast se Garancia Bankare përfshin nënshkrim(et) me dorë, origjinali i Garancisë Bankare të merret nga Platforma e Alokimit.
5. Platforma e Alokimit e konfirmon pranimin e Garancisë Bankare ose i dërgon njoftim refuzimi Pjesëmarrësit të Regjistruar jo më vonë se të paktën katër (4) ditë pune pas marrjes së origjinalit të Garancisë Bankare. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Njoftimi i refuzimit duhet të përfshijë arsyetimin e refuzimit.

Neni 20

Vlefshmëria dhe rinovimi i Garancisë Bankare

1. Kolateralet në formën e Garancisë Bankare janë të vlefshme për periudhën minimale deri në të paktën tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të muajit kalendarik të Periudhës së Produktit.
2. Gjatë kësaj periudhe, Pjesëmarrësi i Regjistruar duhet t'i mbajë kolateralet në çdo kohë në formën e një garancie bankare e cila përfshin detyrimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar për t'i zëvendësuar ose rinovuar ato sipas nevojës

Neni 21

Limiti i kreditit

1. Platforma e Alokimit llogarit dhe përditëson vazhdimisht Limitin e Kreditit të Pjesëmarrësve të

Rregullorja e Alokimit në Hije

Regjistruar për çdo Ankand pasues. Limiti i Kreditit do të jetë i barabartë me shumën e kolateraleve në vend minus çdo detyrim pagese të papaguar. Në rastin e një garancie bankare, kjo garanci bankare do të merret parasysh vetëm nëse plotësohen kërkesat e Nenit 20 për vlefshmërinë e saj për Ankandin Hije përkatës. Platforma e Alokimit e bën këtë informacion të disponueshëm për secilin Pjesëmarrës të Regjistruar individualisht përmes Mjedisit të Ankandit.

2. Detyrimet e papaguara llogariten sipas Nenit 47, duke iu nënshtruar rregullave shtesë të pikave 3 deri 4 të këtij Neni dhe Nenit 32.
3. Për qëllime të llogaritjes së Limitit të Kreditit, detyrimet e papaguara rriten për të përfshirë taksat dhe tatimet në fuqi, objekt i Nenit 48.
4. Detyrimet maksimale të pagesës për Pjesëmarrësin e Regjistruar që rezultojnë nga oferta(t) e tij e regjistruar në mbylljen e Periudhës së Ofertimit, të llogaritur sipas Nenit 32, konsiderohen përkohësisht si detyrimet e papaguara. Nga publikimi i rezultateve të Ankandit Hije, shuma e caktuar e njoftuar sipas nenit 34 paragrafi 3 (b) dhe (c) konsiderohet si detyrim i papaguar për llogaritjen e Limitit të Kreditit për çdo ankand të njëkohshëm dhe Limiti i Kreditit do të rishikohet bazuar në të Drejtat faktike të alokuara të Transmetimit Ditor.

Neni 22

Modifikimet e kolateraleve

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të kërkojë me shkrim rritje të kolateraleve në formën e një garancie bankare, ulje të kolateraleve në formën e një Garancie Bankare dhe/ose depozitim në para ose ndryshim të formës së kolateraleve në çdo kohë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni.
2. Zvogëlimi i kolateraleve të një Pjesëmarrësi të Regjistruar lejohet vetëm nëse Limiti i Kreditit pas aplikimit të uljes së kërkuar të kolateraleve do të ishte më i madh ose i barabartë me zero.
3. Platforma e Alokimit e pranon modifikimin e kolateraleve nëse kërkesa për modifikimin e tyre është në përputhje me kushtin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Neni në rast të uljes ose me kushtet e përcaktuara në Nenet 19 dhe 20 në rast të rritjes së kolateraleve në formën e një Garancie Bankare dhe në rast të ndryshimit të formës së kolateralit nga para në depozitë në Baranci Bankare.
4. Modifikimi i kolateraleve bëhet i vlefshëm dhe hyn në fuqi vetëm kur Platforma e Alokimit ka bërë modifikimin e kërkuar të kolateraleve të Pjesëmarrësit të Regjistruar brenda Mjedisit të Ankandit.
5. Platforma e Alokimit e vlerëson kërkesën për modifikimin e kolateraleve dhe konfirmon pranimin ose i dërgon njoftimin e refuzimit Pjesëmarrësit të Regjistruar, më së shumti dy (2) ditë pune pas marrjes së kërkesës. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Njoftimi i refuzimit duhet të përfshijë arsyetimin e refuzimit.

Neni 23

Incidenti i kolateralit

1. Një Incident kolateral ndodh në rastet e mëposhtme:
 - (a) kolaterale janë të pamjaftueshme për të siguruar shumën e detyrimit për të Drejtat të

Rregullorja e Alokimit në Hije

Transmetimit Ditore të mbajtura nga një Pjesëmarrës i Regjistruar në datën e pagesës së radhës, siç përcaktohet në Nenin 49, duke marrë parasysh shumën dhe vlefshmërinë e kolateraleve; ose

- (b) kolaterale nuk mbahen në përputhje me Nenin 20, paragrafi 2; ose
 - (c) kolaterale nuk janë rikthyer pas një incidenti pagese në përputhje me Nenin 24 ose pasi është dhënë kolateral i ri që nuk është në përputhje me kushtet e specifikuara në Nenet 17(3), 18 dhe 19.
2. Platforma e Alokimit i njofton Pjesëmarrësit e Regjistruar për incidentin e kolateralit me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Pjesëmarrësi i Regjistruar i rrit kolaterale të tij brenda dy (2) ditë pune nga dërgimi i njoftimit nëse kjo bëhet gjatë orarit të punës ose dy (2) ditë pune duke filluar nga dita e ardhshme e punës nëse dërgohet pas orarit të punës. Nëse kolaterale të dhëna nga Pjesëmarrësi i Regjistruar mbeten të pamjaftueshme pas kësaj periudhe, Platforma e Alokimit mund të pezullojë ose ta zgjidhë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në përputhje me Nenet 55 dhe 56.

Neni 24

Thirrjet për kolateral

1. Platforma e Alokimit ka të drejtë të kërkojë kolaterale të një Pjesëmarrësi të Regjistruar në rastin e një incidenti pagese të regjistruar në përputhje me Nenin 51.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar i rivendos kolaterale të tij pas incidentit të pagesës ose pas incidentit të kolateraleve duke ndjekur kushtet e përcaktuara në Nenet 17(3), 18 dhe 19, përveç rastit kur Marrëveshja e Pjesëmarrjes pezullohet ose zgjidhet në përputhje me Nenet 55 dhe 56.

Ankandi në Hije

Neni 25

Dispozitat e përgjithshme për Ankandet në Hije

1. Ankandet Hije mund të aktivizohen ose gjatë një sesioni të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë kur ndodh një incident i paparashikueshëm ose mund të aktivizohen paraprakisht nëse dihet se bashkimi i tregjeve të ditës në avancë nuk do të jetë i disponueshëm për periudhat e ardhshme. Në secilin rast, Platforma e Alokimit njofton sa më shpejt që të jetë e mundur Pjesëmarrësit e Regjistruar të interesuar se Ankandet Hije mund të fillojnë.
2. Platforma e Alokimit do të alokojë të Drejtat e Transmetimit për Pjesëmarrësit e Regjistruar me anë të Alokimit explicit. Ankandet Hije organizohen nëpërmjet Mjedisit të Ankandit. Çdo Pjesëmarrës i Regjistruar që plotëson kërkesat për pjesëmarrje në Ankand Hije mund të bëjë Ofertat për kufijtë e Zonës së Ofertimit për të cilin ka të drejtë sipas Neneve 28 dhe 30.
3. Pasi të ketë skaduar afati përkatës për paraqitjen e ofertave në Ankandin specifik Hije, Platforma e Alokimit vlerëson ofertat duke përfshirë edhe limitet përkatëse të kreditit të pjesëmarrësve të regjistruar. Rezultatet e Ankandit në Hije do t'u njoftohen Pjesëmarrësve të Regjistruar nëpërmjet Mjedisit të Ankandit.

Neni 26

Procesi i Ankandit në Hije

1. Nëse Ankandet Hije aktivizohen gjatë një sesioni të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë, ato mund të nisen paralelisht me zgjidhjen e problemit të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë, por rezultatet e tyre merren parasysh vetëm nëse deklarohet një ndarje e bashkimit të tregjeve. Platforma e Alokimit informon Pjesëmarrësit e Regjistruar të interesuar se Ankandet Hije mund të fillojnë. Pjesëmarrësit e Regjistruar kanë mundësinë të futin ose modifikojnë ofertat e dorëzuara deri në mbyllje - afati i fundit për hyrjen e Ofertave në Ankandet Hije ditore. Platforma e Alokimit importon ofertat e paracaktuara të paraqitura për Ankandet Hije sipas nenit 30 dhe informon Pjesëmarrësit e Regjistruar për afatin e fundit për përditësimin e ofertave të tyre. Rezultatet e Ankandëve në Hije nuk publikohen në këtë moment. Nëse deklarohet përfundimisht shkëputja, Pjesëmarrësit e Regjistruar njoftohen për rezultatet e Ofertave të tyre sipas Nenit 34.

Nëse aktivizimi i Ankandëve Hije dihet paraprakisht për një ose disa sesione të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë, Platforma e Alokimit informon sa më shpejt të jetë e mundur individualisht, me një email, Pjesëmarrësit e Regjistruar se Ankandet Hije kryhen me orarin e ri përkatës. Kapaciteti i ofruar për Ankandet në Hije dhe informacioni për orarin publikohen në specifikimin e Ankandit në faqen e internetit të Platformës së Alokimit siç specifikohet në Nenin 27 në mënyrë që t'u jepet mundësia pjesëmarrësve të përditësojnë ofertat e tyre sipas neneve 28, 29 dhe 30.

2. Platforma e Alokimit nuk mban përgjegjësi në asnjë rrethanë nëse nuk mund të kontaktojë Pjesëmarrësit e Regjistruar ose nëse nuk mund të publikojë një njoftim në faqen e saj të internetit.

Neni 27

Specifikimi i Ankandit

1. Specifikimi i Ankandit publikohet 15 minuta përpara hapjes së periudhës së ofertave.

Rregullorja e Alokimit në Hije

2. Nëse aktivizimi i ankandeve Hije njihet paraprakisht, Platforma e Alokimit informon sa më shpejt të jetë e mundur Pjesëmarrësit e Regjistruar për të cilat kryhen sesionet ditore dhe për të cilat Zona e Ofertimit kufizohet me Ankandet Hije.
3. Specifikimi i Ankandit përcakton në veçanti:
 - (a) kodin që identifikon Ankandin Hije në Mjedisin e Ankandit;
 - (b) identifikimin e kufirit(ve) të Zonës së Ofertimit ose një nëngrupi të Ndërlidhësve në kufirin e Zonës së Ofertimit dhe drejtimin e mbuluar;
 - (c) Periudhën e Produktit;
 - (d) Periudhën e Ofertimit e cila zgjat 15 minuta;
 - (e) afatin për publikimin e rezultateve të përkohshme të Ankandit Hije;
 - (f) periudhën e kontestimit në përputhje me Nenin 34;
 - (g) afatin e fundit për publikimin e rezultateve përfundimtare të Ankandit Hije;
 - (h) Kapacitetin e Ofruar; dhe
 - (i) çdo informacion ose term tjetër përkatës të zbatueshëm për produktin ose Ankandin Hije.

Neni 28 Dorëzimi i ofertave

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar dorëzon një Ofertë ose grup Ofertash në Platformën e Alokimit në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - (a) dorëzohet në mënyrë elektronike duke përdorur Mjedisin e Ankandit dhe gjatë periudhës së ofertimit siç specifikohet në Specifikimin e Ankandit;
 - (b) identifikon Ankandin Hije nëpërmjet një kodi identifikimi siç specifikohet në Nenin 27 paragrafi 2 (a);
 - (c) identifikon Pjesëmarrësin e Regjistruar që dorëzon Ofertën përmes kodit të tij EIC;
 - (d) identifikon kufirin e Zonave të Ofertimit dhe drejtimin për të cilin është dorëzuar Oferta;
 - (e) deklaron Çmimin e Ofertës i cili do të jetë i ndryshëm për secilën Ofertë të të njëjtit Pjesëmarrës të Regjistruar, pa taksë dhe tatime, në Euro për MW për një orë të Periudhës së Produktit, d.m.th. Euro/MW dhe orë, e shprehur në maksimumi dy (2) shifra dhjetore dhe të barabarta ose më të mëdha se zero;
 - (f) tregon Sasinë e Ofertës në MW të plotë e cila duhet të shprehet pa numra dhjetorë, shuma minimale e një Oferte të vetme është një (1) MW.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund ta modifikojë Ofertën e tij të regjistruar më parë ose grupin e Ofertave në çdo kohë gjatë Periudhës së Ofertimit duke përfshirë anulimin e saj. Në rast se

Rregullorja e Alokimit në Hije

Oferta është modifikuar, për përcaktimin e rezultateve të Ankandit Hije do të merret parasysh vetëm modifikimi i fundit i vlefshëm i Ofertës ose grupit të Ofertave.

3. Nëse Sasia e Ofertës, ose një sasi e llogaritur si shumë e Sasisë së Ofertës për disa Oferta të paraqitura për të njëjtin Ankand Hije gjatë Periudhës së Ofertimit nga një Pjesëmarrës i Regjistruar e tejkalon kapacitetin e ofruar të shpallur në Specifikimin e Ankandit, kjo Ofertë ose këto Oferta refuzohen plotësisht. Kur modifikimi i ofertave të dorëzuara më parë rezultojnë në tejkalimin e Kapacitetit të Ofruar, modifikimi refuzohet dhe Ofertat e regjistruara më parë mbeten në fuqi.

Neni 29

Regjistrimi i ofertës

1. Platforma e Alokimit nuk e regjistron Ofertën e cila:
 - (a) nuk përputhet me kërkesat e Nenit 28; ose
 - (b) është dorëzuar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar i cili është pezulluar në përputhje me Nenin 55.
2. Me kushtin që një Ofertë ose një grup Ofertash t'i plotësojë kërkesat e përcaktuara në Nenin 28, Platforma e Alokimit do t'i konfirmojë Pjesëmarrësit të Regjistruar që Oferta(a) të tilla janë regjistruar saktë me një dëshmi të marrjes nëpërmjet Mjedisit të Ankandit. Nëse Platforma e Alokimit nuk lëshon dëshmi për marrjen e një Oferte, kjo Ofertë konsiderohet e paregjistruar.
3. Platforma e Alokimit e njofton Pjesëmarrësin e Regjistruar, Oferta e të cilit është refuzuar si e pavlefshme dhe i jep arsyen e këtij refuzimi pa vonesa të panevojshme pas refuzimit të Ofertës.
4. Platforma e Alokimit mban një regjistër të të gjitha Ofertave të vlefshme të pranuar.
5. Çdo Ofertë e vlefshme e regjistruar në mbyllje të Periudhës së Ofertimit përbën një Ofertë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për të blerë të Drejtat e Transmetimit Ditor brenda Sasisë dhe Çmimit të Ofertës dhe sipas termave dhe kushteve të Rregullores së Alokimit Hije dhe Specifikimeve të Ankandit përkatës.

Neni 30

Oferta e paracaktuar

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar që dëshiron të marrë pjesë në Ankandet Hije ka mundësinë të paraqesë Oferta të paracaktuara për Ankandet Hije.
2. Oferta e paracaktuar, pasi të identifikohet si e tillë nga Pjesëmarrësi i Regjistruar, zbatohet automatikisht për çdo Ankand Hije vijues përkatës, siç përcaktohet nga Pjesëmarrësi i Regjistruar kur bën Ofertën e paracaktuar. Në hapjen e periudhës Përkatëse të Ofertimit, Oferta e regjistruar e paracaktuar do të konsiderohet si Ofertë e dorëzuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për Ankandin Hije përkatës. Kjo Ofertë konsiderohet si Ofertë e dorëzuar kur Platforma e Alokimit i dërgon një dëshmi të marrjes Pjesëmarrësit të Regjistruar.
3. Nëse Sasia e Ofertës së paracaktuar ose sasia e llogaritur si shuma e Sasisë së Ofertës për disa Oferta të paracaktuara të paraqitura për të njëjtin Ankand Hije nga një Pjesëmarrës i Regjistruar e tejkalon kapacitetin përfundimtar të ofruar, Ofertat me Çmimin më të ulët të Ofertës refuzohen një (1) nga një (1) derisa sasia totale e lejuar e Ofertës të jetë më e vogël ose e

Rregullorja e Alokimit në Hije

barabartë me Kapacitetin e Ofruar.

4. Pjesëmarrësi i Regjistruar i cili dëshiron të modifikojë një Ofertë të paracaktuar për një Ankand Hije të ardhshëm duhet të ndryshojë Sasinë e Ofruar dhe Çmimin e Ofertës të Ofertave të paracaktuara përpara hapjes së Periudhës së Ankandit Hije.
5. Pjesëmarrësi i Regjistruar i cili nuk dëshiron të dorëzojë ofertën e paracaktuar në Mjedisin e Ankandit për Ankandet Hije të ardhshme, mund t'i anulojë Ofertat e tij të paracaktuara përpara se të fillojë hapja e Periudhës së Ankandit Hije.

Neni 31

Oferta e paracaktuar për Ankand rezervë

Në rast se zhvillohet një Ankand rezervë në përputhje me Nenin 42, Ofertat e paracaktuara të dorëzuara deri në orën 14:00 D-2 do të përdoren si Oferta të paracaktuara për Ankand rezervë .

Neni 32

Verifikimi i Limitit të Kreditit

1. Me dorëzimin nga një Pjesëmarrës i Regjistruar i një Oferte ose një grupi Ofertash në Mjedisin e Ankandit, Platforma e Alokimit kontrollon nëse detyrimet maksimale të pagesës (MPO) që lidhen me ofertën(at) e regjistruara të atij Pjesëmarrësi të Regjistruar të llogaritura sipas paragrafëve 4 dhe 5 të këtij Neni në kohën e dorëzimit të Ofertave e tejkalojnë Limitin e Kreditit. Nëse detyrimi maksimal i pagesës në lidhje me ofertat e tilla të regjistruara e tejkalon Limitin e Kreditit, Platforma e Alokimit lëshon automatikisht nëpërmjet Mjedisit të Ankandit një paralajmërim për Pjesëmarrësin e Regjistruar që të modifikojë ofertat. Ofertat nuk refuzohen automatikisht nëse detyrimi maksimal i pagesës që i atribuohet ofertave të regjistruara e tejkalon Limitin e Kreditit në dorëzimin e Ofertës, por vetëm pas procesit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Në mbyllje të periudhës së tenderimit, Platforma e Alokimit kontrollon sërish nëse detyrimet maksimale të pagesës që lidhen me Ofertat e regjistruara të llogaritura sipas paragrafit 5 të këtij Neni e kalojnë Limitin e Kreditit. Nëse detyrimet maksimale të pagesës në lidhje me këto Oferta e tejkalojnë Limitin e Kreditit, këto oferta, duke filluar me Ofertën me çmimin më të ulët, përjashtohen një (1) nga një (1), derisa detyrimet maksimale të pagesës të jenë më të vogla ose të barabarta me Limitin e Kreditit.
3. Platforma e Alokimit i identifikon kolateralet e pamjaftueshme si arsye për përjashtimin e Ofertës nga njoftimi i rezultateve të Ankandit Hije ndaj Pjesëmarrësit të Regjistruar.
4. Platforma e Alokimit i vlerëson vazhdimisht të gjitha Ofertat, pavarësisht se në cilin Ankand Hije dhe në cilin kufi e drejtim të Zonës së Ofertimit janë dorëzuar. Në rastin e Ofertave të lidhura me Ankande të ndryshme dhe të mbivendosura, Platforma e Alokimit i konsideron të gjitha detyrimet maksimale të llogaritura të pagesës si detyrime pagese të papaguara sipas Nenit 21.
5. Për llogaritjen e detyrimeve maksimale të pagesës në lidhje me kufirin dhe drejtimin e një Zone të Ofertimit, Platforma e Alokimit i rendit Ofertat e regjistruara të një Pjesëmarrësi të Regjistruar sipas Çmimit të Ofertës në rend zbritës (meritë-porosi). Oferta 1 do të jetë Oferta me Çmimin e Ofertës më të lartë dhe Oferta n do të jetë Oferta me Çmimin e Ofertës më të ulët. Platforma e Alokimit i llogarit detyrimet maksimale të pagesës sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$MPO = \sum_{hours} MAX \left[BidPrice(1) * BidQuantity(1); BidPrice(2) * \sum_{i=1}^2 BidQuantity(i); \dots \right. \\ \left. \dots; BidPrice(n-1) * \sum_{i=1}^{n-1} BidQuantity(i); BidPrice(n) * \sum_{i=1}^n BidQuantity(i) \right]$$

6. Në llogaritjen e detyrimeve maksimale të pagesës sipas paragrafit 5 të këtij Neni, Platforma e Alokimit merr parasysh edhe rritjen e detyrimeve maksimale të pagesës me taksat dhe tatimet në fuqi sipas Nenit 48.

Neni 33

Përcaktimi i Rezultateve të Ankandit Hije

1. Pas mbarimit të Periudhës së Ofertimit për një Ankand Hije dhe verifikimit të Limitit të Kreditit në përputhje me Nenin 32, Platforma e Alokimit përcakton rezultatet e Ankandit Hije dhe ndan të Drejtat e Transmetimit Ditor në përputhje me këtë Nen.
2. Përcaktimi i rezultateve të Ankandit Hije përfshin sa më poshtë:
 - (a) përcaktimin e sasisë totale të të Drejtave të Transmetimit Ditore të alokuara sipas kufirit dhe drejtimit të Zonës së Ofertimit;
 - (b) identifikimin e Ofertave fituese për t'u përmbushur plotësisht ose pjesërisht; dhe
 - (c) përcaktimin e Çmimit Marxhinal për kufirin dhe drejtimin e Zonës së Ofertimit.
3. Platforma e Alokimit i përcakton rezultatet e Ankandit Hije duke përdorur një funksion optimizimi që synon maksimizimin e shumës së tepricës së Pjesëmarrësve të Regjistruar dhe të Ardhurave të Kongjestionit të krijuara nga Ofertat fituese duke respektuar kufizimet e funksionit të optimizimit në formën e Kapaciteteve përkatëse të Ofruara. Platforma e Alokimit publikon në faqen e saj të internetit informacion shpjegues shtesë mbi funksionin e optimizimit të algoritmit.
4. Platforma e Alokimit e përcakton Çmimin Marxhinal në çdo kufi dhe drejtim të Zonës së Ofertimit bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - (a) nëse sasia totale e Kapacitetit Ndërzonal për të cilin janë dorëzuar Ofertat e vlefshme është më e ulët ose e barabartë me Kapacitetin përkatës të Ofruar për Ankandin Hije përkatës, atëherë Çmimi Marxhinal do të jetë zero;
 - (b) nëse sasia totale e Kapacitetit Ndërzonal për të cilin janë dorëzuar Ofertat e vlefshme tejkalon Kapacitetin përkatës të Ofruar për Ankandin Hije përkatës, Çmimi Marxhinal vendoset në Çmimin(Çmimet) e Ofertës(ofertave) më të ulët të alokuar plotësisht ose pjesërisht duke përdorur Kapacitetet përkatëse të Ofruara.
5. Nëse dy (2) ose më shumë Pjesëmarrës të Regjistruar kanë dorëzuar Oferta të vlefshme me të njëjtin Çmim Oferte për një kufi dhe drejtim Zone Ofertimi, që nuk mund të pranohen plotësisht për sasinë totale të kërkuar të të Drejtave të Transmetimit Ditor, Platforma e Alokimit përcakton Ofertat fituese dhe sasinë e të Drejtave të Transmetimit Ditor të alokuara për Pjesëmarrës të

Rregullorja e Alokimit në Hije

Regjistruar si më poshtë:

- (a) Kapaciteti Ndërzonal i disponueshëm për Ofertat që përcakton Çmimin Marxhinal ndahet në mënyrë të barabartë midis numrit të Pjesëmarrësve të Regjistruar që kanë dorëzuar këto Oferta;
 - (b) në rast se sasia e të Drejtave të Transmetimit Ditor të kërkuara nga një Pjesëmarrës i Regjistruar me Çmimin Margjinal është më e ulët ose e barabartë me pjesën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij Pjesëmarrësi të Regjistruar do të plotësohet plotësisht;
 - (c) në rast se sasia e kërkuar e të Drejtave të Transmetimit Ditor nga një Pjesëmarrës i Regjistruar me Çmimin Marxhinal tejkalon pjesën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij Pjesëmarrësi të Regjistruar do të plotësohet deri në shumën e aksionit të llogaritur sipas pikës (a) më sipër;
 - (d) çdo Kapacitet Ndërzonal i mbetur pas alokimit sipas pikave (b) dhe (c) pjesëtohet me numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar, kërkesat e të cilëve nuk janë përmbushur plotësisht dhe u ndahen atyre duke zbatuar procesin e përshkruar në pikat (a), (b) dhe (c) më sipër;
 - (e) çdo Kapacitet Ndërzonal i mbetur pas alokimit sipas pikës (d), ndahet duke përdorur kriteret e paraqitjes kronologjike (vula kohore).
6. Sa herë që llogaritja e përcaktuar në paragrafët 3 deri në 5 të këtij Neni nuk rezulton në sasi të plotë MW në përputhje me Nenin 28, paragrafi 1(f), të Drejtat e Transmetimit Ditor rrumbullakosen në MW-në e plotë më të afërt. Rasti kur të Drejtat e Transmetimit Ditor të alokuara për Pjesëmarrësit individualë të Regjistruar janë të barabarta me zero pas rrumbullakimit nuk ndikon në përcaktimin e Çmimit Marxhinal.

Neni 34

Njoftimi i Rezultateve të Ankandit Hije

1. Të Drejtat e Transmetimit konsiderohen se i janë alokuar një Pjesëmarrësi të Regjistruar që nga momenti kur Pjesëmarrësi i Regjistruar është informuar për rezultatet dhe, sipas rastit, jo më vonë se 30 minuta pasi rezultatet e përkohshme të Ankandit Hije janë njoftuar në përputhje me këtë Nen.
2. Platforma e Alokimit publikon në faqen e saj të internetit rezultatet e Ankandit Hije sapo të deklarohet përfundimisht ndarja e bashkimit të tregjeve, jo më vonë se ora 14:20 p.m. në ditën pasuese të dorëzimit dhe rezultatet e Ankandit Hije të jenë përcaktuar sipas Nenit 33. Për Ankandet Hije të njohura paraprakisht, rezultatet publikohen në përputhje me Nenin 27.
3. Publikimi i rezultateve të Ankandit Hije për çdo kufi të Zonës së Ofertimit dhe orë të ditës të përfshira në Ankandin Hije duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - (a) Të Drejtat e Transmetimit Ditor totale të kërkuara në MW;
 - (b) Të Drejtat e Transmetimit Ditor totale të alokuara në MW;
 - (c) Çmimin Marxhinal në Euro/MW për orë;

Rregullorja e Alokimit në Hije

- (d) numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar që marrin pjesë në Ankandin Hije;
 - (e) listën e emrave dhe numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar që kanë dorëzuar të paktën një Ofertë fituese në Ankandin Hije;
 - (f) listën e Ofertave të regjistruara pa identifikimin e Pjesëmarrësve të Regjistruar (kurba e ofertës); dhe
 - (g) Të Ardhurat e Kongjestionit nga Ankandet Hije për kufirin e Zonës së Ofertimit.
4. Në të njëjtën kohë me publikimin e rezultateve të Ankandit Hije, Platforma e Alokimit njofton nëpërmjet Mjedisit të Ankandit çdo Pjesëmarrës të Regjistruar që ka dorëzuar një Ofertë në një Ankand Hije specifik për çdo kufi të Zonës së Ofertimit të përfshirë në Ankandin Hije, të paktën të dhënat e mëposhtme:
- (a) të Drejtat e Transmetimit Ditor të alokuara për çdo orë të Periudhës së Produktit në MW;
 - (b) Çmimin Marxhinal në Euro/MW për orë; dhe
 - (c) shumën e pagueshme për të Drejtat e Transmetimit Ditor të alokuar në Euro (€), të rrumbullakosur në dy shifra dhjetore; dhe
 - (d) CAI-n e caktuar për të Drejtat e Transmetimit Ditor të alokuara.
5. Në rast se Mjeti i Ankandit nuk është i disponueshëm, Platforma e Alokimit do të informojë Pjesëmarrësit e Regjistruar për rezultatet e Ankandit Hije në përputhje me Nenin 6.
6. Për Ankandet në Hije të nxitura gjatë një intervali ditore të bashkimit të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë nuk është i mundur asnjë kontestim i rezultateve të përkohshme të Ankandit Hije.
7. Për Ankandet në Hije të vendosura paraprakisht, Pjesëmarrësi i Regjistruar mund t'i kundërshtojë rezultatet e Ankandit në Hije brenda afatit të përcaktuar në specifikimin përkatës të Ankandit. Platforma e Alokimit duhet të shqyrtojë vetëm kontestimin ku pjesëmarrësi i regjistruar është në gjendje të demonstrojë një gabim nga Platforma e Alokimit në rezultatet e Ankandit në Hije.
8. Kontestimi do t'i njoftohet Platformës së Alokimit dhe do të titullohet si "Kontestimi".
9. Çdo kontestim duhet të përmbajë sa vijon:
- (a) Datën e kontestimit;
 - (a) identifikimin e Ankandit Hije të kontestuar;
 - (b) identifikimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar;
 - (c) emrin, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të Pjesëmarrësit të Regjistruar;
 - (d) përshkrimin e detajuar të fakteve dhe arsyt e kontestimit; dhe
 - (e) dëshmi të rezultateve të gabuara të Ankandit Hije;

Rregullorja e Alokimit në Hije

10. Platforma e Alokimit i përgjigjet Pjesëmarrësit të Regjistruar jo më vonë se 1 orë pasi rezultatet e përkohshme të Ankandit në Hije u janë njoftuar Pjesëmarrësve të Regjistruar.
11. Në rast se nuk merret asnjë kontestim brenda afatit të përcaktuar në Specifikimin përkatës të Ankandit, rezultatet e përkohshme të Ankandit në Hije publikohen si përfundimtare dhe do të jenë të disponueshme në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.

Përdorimi i të Drejtave të Transmetimit

Neni 35

Parime të përgjithshme

1. Të Drejtat e Transmetimit Fizik të alokuara në Ankandin Hije i nënshtrohen parimit “Përdore ose humbe” pa kompensim financiar.
2. Mbjtësi i të Drejtave të Transmetimit Fizik të alokuara mund t’i emërojë të Drejtat e Transmetimit Fizik për përdorimin e tij fizik në përputhje me Nenin 36.

Neni 36

Nominimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik

1. Personat që kanë të drejtë të nominojnë të Drejta të Transmetimit Fizik duhet të përmbushin kërkesat e përshkruara në Rregulloren e Emërimit në fuqi. Personat e kualifikuar mund të jenë:
 - (a) mbajtësi i të Drejtave të Transmetimit Fizik;
 - (b) personi i njoftuar nga mbajtësi i të Drejtave të Transmetimit Fizik gjatë procesit të Nominimit tek Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit në përputhje me Rregulloren përkatëse të Nominimit;
2. Platforma e Alokimit ofron në faqen e saj të internetit një përmbledhje të opsioneve të renditura në paragrafin 1 të këtij Neni, të cilat janë të zbatueshme në çdo kufi të Zonës Ofertuese.
3. Nominimi bëhet në përputhje me dokumentin e të drejtave të transmetimit.
4. Platforma e Alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit një listë me rregullat përkatëse të nominimit për kufijtë e zonës së ofertimit.
5. Afatet e Nominimit për kufijtë përkatës të zonës së ofertimit përcaktohen në rregulloren përkatëse të nominimit. Platforma e Alokimit publikon në faqen e saj të internetit informacion për afatet e nominimit për kufirin e zonës së ofertimit. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis afateve të publikuara nga Platforma e Alokimit dhe atyre të rregulloreve përkatëse të vlefshme dhe ligjërish të detyrueshme të nominimit, mbizotëron kjo e fundit dhe Platforma e Alokimit nuk mbahet përgjegjëse për asnjë dëmtim që rrjedh nga kjo mospërputhje.

Neni 37

Dokumenti i të Drejtave të Transmetimit Fizik

1. Dokumenti i të drejtave të transmetimit përmban informacion për vëllimin në MW që personat e kualifikuar kanë të drejtë të nominojnë në kufijtë dhe drejtimet të zonës së ofertimit specifike dhe për periudha orare.
2. Platforma e Alokimit e dërgon dokumentin e të drejtave të transmetimit çdo ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pasi rezultatet e Ankandit në Hije t’i jenë njoftuar Pjesëmarrësit të regjistruar te personi i kualifikuar sipas Nenit 36, paragrafi 1 (a).

Neni 38

Rezervimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik për shërbimet balancuese

Të drejtat e transmetimit fizik të fituara në Ankandet në Hije nuk janë objekt i rezervimit për shërbimet balancuese.

Procedura Rezervë

Neni 39

Dispozita të përgjithshme

1. Platforma e Alokimit, për aq sa është praktikisht e arsyeshme, organizon procedurën rezervë në rastet e mëposhtme të dështimit të një procesi standard:
 - (a) nëse nuk është e mundur teknikisht të mbahet një Ankand Hije, për shembull në rastet e mëposhtme:
 - nëse nuk është e mundur teknikisht të përdoret procedura standarde e shkëmbimit të të dhënave; ose
 - në rast se Platforma e Alokimit përballlet me pengesa teknike gjatë procesit të Ankandit Hije; ose
 - (b) në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të Çmimit Marxhinal; ose
 - (c) në rast të Alokimit të gabuar të të Drejtave të Transmetimit Ditor për Pjesëmarrësit e Regjistruar ose arsye të ngjashme.
2. Platforma e Alokimit mund të përdorë një ose të gjitha procedurat e mëposhtme:
 - (a) futjen e procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave sipas Nenit 40;
 - (b) futjen e procedurës rezervë për Ankandin Hije sipas Nenit 41;
 - (c) një tjetër procedurë ad hoc shtesë nëse konsiderohet e përshtatshme nga Platforma e Alokimit për të kapërcyer pengesat teknike.
3. Platforma e Alokimit, për aq sa është e mundur dhe pa vonesa të panevojshme, informon Pjesëmarrësit e Regjistruar për devijimet e mundshme nga proceset standarde dhe aplikimin e një procedure rezervë nëpërmjet mjeteve elektronike sikurse specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit dhe duke përdorur Mjedisin e Ankandit.
4. Pjesëmarrësit e Regjistruar informojnë menjëherë Platformën e Alokimit për çdo problem të vërejtur me përdorimin e Mjedisit të Ankandit dhe të gjitha pasojat e mundshme nëpërmjet mjeteve elektronike sikurse specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Në rast të një problemi urgjent, i cili do të zgjidhet menjëherë dhe që identifikohet gjatë orarit të punës, Pjesëmarrësi i Regjistruar kontakton menjëherë Platformën e Alokimit me telefon në numrin e treguar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit për këtë lloj problemi. Platforma e Alokimit konfirmon marrjen e problemit dhe informon Pjesëmarrësit e Regjistruar për statusin e problemit sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 40

Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave

1. Në rast të dështimit, në mjedisin e Platformës së Alokimit, të proceseve standarde për shkëmbimin e të dhënave nëpërmjet Mjedisit të Ankandit sikurse përshkruhet në Rregulloren e Alokimit në Hije, Platforma e Alokimit mund të informojë Pjesëmarrësit e Regjistruar se mund të përdoret një procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave si më poshtë:
 - (a) brenda afateve të zbatueshme, përveçse nëse shpallet ndryshe nga Platforma e Alokimit, Pjesëmarrësi i Regjistruar kërkon nëpërmjet mjeteve elektronike sikurse specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, të futë të dhënat përkatëse në Mjedisin e Ankandit duke përdorur këtë procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave;
 - (b) me kërkesë, Pjesëmarrësi i Regjistruar i ofron Platformës së Alokimit të dhënat përkatëse që do të futen në Mjedisin e Ankandit në formatin e specifikuar nga Rregullorja e Sistemit të Informacionit;
 - (c) Platforma e Alokimit vendos të dhënat e paraqitura në Mjedisin e Ankandit;
 - (d) Platforma e Alokimit mund të vendosë në rregullat e sistemit të Informacionit një proces identifikimi për Pjesëmarrësin e Regjistruar në momentin kur ky i fundit dorëzon të dhënat përkatëse operationale ose tregtare dhe i kërkon Platformës së Alokimit që t'i fusë këto të dhëna në Mjedisin e Ankandit në emër të tij me anë të procedurës rezervë. Nëse pjesëmarrësi i regjistruar ose personi i autorizuar prej tij për këtë qëllim nuk e identifikon veten qartë, Platforma e Alokimit gëzon të drejtën të mos kryejë futjen e të dhënave;
 - (e) Pjesëmarrësi i regjistruar i ofron Platformës së Alokimit një numër telefoni, i cili mund të përdoret në rast të komunikimit të nevojshëm;
 - (f) Pasi Platforma e Alokimit të ketë futur të dhënat në Mjedisin e Ankandit në emër të Pjesëmarrësit të Regjistruar, ajo informon pa vonesa të panevojshme Pjesëmarrësin e regjistruar me telefon dhe/ose nëpërmjet mjeteve elektronike sikurse specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të hyrjes; dhe
 - (g) Platforma e Alokimit nuk mban përgjegjësi në asnjë rrethanë nëse nuk mundet të arrijë tek pjesëmarrësi i regjistruar përmes mjeteve të komunikimit të mësipërm ose nëse nuk arrin të vendosë të dhënat në mënyrë korrekte nëpërmjet procedurës rezervë.
2. Në rastin e aplikimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave, i gjithë informacioni i nevojshëm që vihet në dispozicion nëpërmjet Mjedisit të Ankandit gjatë proceseve standarde mund t'u shpërndahet pjesëmarrësve të regjistruar nëpërmjet mjeteve elektronike sikurse specifikohet nga Platforma e Alokimit ose kur është e përshtatshme të publikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.

Neni 41

Procedura rezervë për Ankandin në Hije

1. Pas hapjes së Periudhës së Ofertimit, Platforma e Alokimit:
 - (a) kur është praktikisht e arsyeshme, shtyn fundin e Periudhës së Ofertimit duke njoftuar

Rregullorja e Alokimit në Hije

Pjesëmarrësit e Regjistruar për afatet e rishikuara në Specifikimin e Ankandit; ose

- (b) anulon ankandin fillestar sipas Nenit 43; dhe organizon një Ankand të ri për të njëjtën Periudhë Produkti; ose
 - (c) zbaton Ankandin rezervë , sikurse specifikohet në Nenin 42.
2. Nëse procedura rezervë e përshkruar në paragrafin 1 të këtij Neni nuk mund të zbatohet për të njëjtën periudhë produkti, kapacitetet përkatëse ndërzonale ofrohen në procesin pasues të Alokimit të Kapaciteteve.

Neni 42 Ankandi Rezervë

1. Nëse Platforma e Alokimit, pas publikimit të specifikimeve të ankandit, nuk mund të realizojë Proceset e Ankandit në Hije për arsyet e renditura në Nenin 39, paragrafi 1, ajo u dërgon njoftimin të gjithë Pjesëmarrësve të Regjistruar për aplikimin e Ankandit Rezervë , sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se ora 14:10 p.m. në ditën para ditës së lëvrimit.
2. Në rastin e Ankandit rezervë, do të merren parasysh vetëm ofertat e paracaktuara për Ankand Rezervë , në përputhje me Nenin 31. Nëse sasia e ofertës së paracaktuar ose një sasi e llogaritur si shuma e sasive të ofertave për disa oferta të paracaktuara të paraqitura për të njëjtin Ankand në Hije nga pjesëmarrësi i regjistruar e tejkalon kapacitetin përfundimtar të ofruar, sasia e ofertës reduktohet për të qenë e barabartë me kapacitetin e ofruar.
3. Kapaciteti i ofruar ndahet në pjesë proporcionale ndërmjet pjesëmarrësve të regjistruar.
4. Çmimi marxhinal i të Drejtave të Transmetimit Ditor është 0 €/MWh. Vlera e të Drejtave të Transmetimit Ditor rrumbullakoset në MW-në e plotë më të afërt.
5. Pjesëmarrësit e regjistruar njoftohen për rezultatet deri në orën 14:20 p.m, në D-1.

Neni 43 Anullimi i Ankandit në Hije

6. Në rast se Platforma e Alokimit anulon Ankandin në Hije, të gjitha ofertat e dorëzuara tashmë dhe çdo rezultat i Ankandit në Hije përkatës konsiderohen të pavlefshme.
7. Platforma e Alokimit informon të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar pa vonesa të panevojshme, për anulimin e Ankandit në Hije nëpërmjet njoftimit të publikuar në Mjedisin e Ankandit ose në faqen e internetit të Platformës së Alokimit dhe me email.
8. Anullimi i Ankandit në Hije mund të shpallet në rastet e mëposhtme:
 - (a) përpara se Kapaciteti Ndërzonal të konsiderohet i alokuar në rast se Platforma e Alokimit përballlet me pengesa teknike gjatë procesit të Ankandit në Hije, si p.sh., dështimi i proceseve standarde dhe procedurave rezervë ose arsye të ngjashme; dhe
 - (b) gjatë periudhës së kontestimit, në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të Çmimit Marxhinal ose alokimit së gabuar të të drejtave të transmetimit për pjesëmarrësit e regjistruar ose arsye të ngjashme.

Rregullorja e Alokimit në Hije

9. Në rast të anulimit të Ankandit në Hije përpara publikimit përfundimtar të rezultateve të Ankandit Hije, Pjesëmarrësve të Regjistruar nuk do t'u paguhet kompensim.
10. Platforma e Alokimit publikon në faqen e saj të internetit, pa vonesa të panevojshme, arsyet e anulimit të Ankandit në Hije.
11. Dispozitat e këtij Neni 43 mund të zbatohen edhe për Ankandin rezervë (në rast të rezultateve të gabuara).

Reduktimet

Neni 44

Ngjarjet nxitëse dhe pasojat e kufizimit të të Drejtave të Transmetimit Ditor

1. Të Drejtat e Transmetimit Ditor mund të reduktohen vetëm në rast të Forcës Madhore ose situatës emergjente.
2. Reduktimi mund të zbatohet për të Drejtat e Transmetimit Ditor të alokuara, duke përfshirë, sipas rastit, të drejtat e nominuara të Transmetimit Fizik.
3. Çdo Pjesëmarrës i Regjistruar i prekur nga reduktimi e humbet të drejtën e tij për të nominuar për përdorim fizik të Drejtat përkatëse të Transmetimit Fizik nëse kjo e drejtë ekziston në momentin e reduktimit.
4. Në rast reduktimi, Pjesëmarrësi i Regjistruar i prekur nuk ka të drejtë të marrë asnjë rimbursim ose kompensim në lidhje me të ose si pasojë e tij.

Neni 45

Procesi dhe njoftimi i reduktimeve

Në të gjitha rastet, reduktimi kryhet nga një ose më shumë Operatorë të Sistemit të Transmetimit në kufirin e Zonës Ofertuese ku janë alokuar të Drejtat e Transmetimit Ditor.

Faturimi dhe Pagesa

Neni 46 Parime të përgjithshme

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të paguajë shumat e pagueshme sikurse janë llogaritur në përputhje me Nenin 47 për të gjitha të Drejtat e Transmetimit që i janë alokuar.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të përdorë me pagesë kapacitetin ndërzonal të lidhur me të Drejtat e Transmetimit të alokuara sikurse përshkruhet vetëm në Rregulloren e Alokimit Hije.
3. Të gjitha informacionet financiare, çmimet dhe shumat e detyrimeve shprehen në Euro (€), përveçse nëse kërkohet ndryshe nga ligji ose rregulloret në fuqi.
4. Pagesa shlyhet në datën në të cilën shuma e dhënë është kredituar në llogarinë e përfituesit. Çdo kamatëvonesë konsiderohet e shlyer në datën kur pagesa është kredituar nga llogaria e paguesit.
5. Pagesat kryhen në euro (€).
6. Platforma e Alokimit i konsideron taksat dhe tatimet me normën dhe në masën e zbatueshme kur vlerëson detyrimet e pagesave dhe lëshon faturat sipas Rregullores së Alokimit Hije që i nënshtrohen Nenit 48.
7. Pjesëmarrësi i regjistruar do t'i ofrojë Platformës së Alokimit informacionin përkatës për të justifikuar nëse taksat dhe tatimet përkatëse janë ose jo të zbatueshme gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, si dhe çdo ndryshim në këtë drejtim pa vonesa të panevojshme. Prandaj, është detyrimi i pjesëmarrësit të regjistruar të informojë Platformën e Alokimit për çdo taksë dhe tatim lokal, brenda ose jashtë komunitetit që është në përputhje me legjislacionin e vendit të themelimit të pjesëmarrësit të regjistruar.

Neni 47 Llogaritja e shumave të pagueshme

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar paguajnë për secilën nga të Drejtat e Transmetimit që u janë alokuar dhe për orë individuale një shumë të barabartë me:
 - (a) Çmimin Marxhinal (për MW në orë); shumëzuar me
 - (b) Të Drejtat e Transmetimit Ditor në MW të alokuara në orë individuale të ditës.
2. Të Drejtat e Transmetimit faturohen çdo muaj. Platforma e Alokimit llogarit shumën e detyrimit për t'u paguar në mënyrë retroaktive për muajin paraardhës. Shuma e detyrimit plus çdo taksë dhe tatim, detyrime apo tarifa të tjera të zbatueshme, sipas Nenit 48, do të rrumbullakoset në dy shifra dhjetore.

Neni 48 Shtesa për Taksat

1. Çdo Pjesëmarrës i Regjistruar duhet t'i shlyejë të gjitha pagesat për Rregullat e Alokimit Hije pa zbritje tatimore, përveç rasteve kur zbritja tatimore kërkohet me ligj.

Rregullorja e Alokimit në Hije

2. Nëse kërkohet me ligj që zbritja tatimore të bëhet nga pjesëmarrësi i regjistruar, shuma që i kërkohet Pjesëmarrësit të Regjistruar në Platformën e Alokimit do të rritet në një shumë që (pas aplikimit të zbritjes tatimore) lë një shumë të barabartë me pagesën e kërkuar nëse nuk do të ishte kërkuar zbritja tatimore.
